



REFERIMET PAS TESTIT TË SYVE... ÇFARË DO TË NDODHË?

Fëmija juaj ka bërë një testim të syve. Rezultati i testit nuk i ka plotësuar normat e pritshme. Fëmija juaj është referuar tek okulisti për kontrolle të mëtejshme. Prandaj ne duam t'ju japim informacion shtesë se çfarë do të thotë kjo dhe çfarë mund të prisni.

QËLLIMI DHE RËNDËSIA E TESTIT TË SYVE

Testi i syve kontrollon rrezikun e zhvillimit të "syrit dembel". Ne e dimë se nëse kjo zbulohet në kohë, është e mundur të parandalohet që fëmija të zhvillojë "sy dembel". Një "sy dembel" (Termi mjekësor "ambliopi") është shikim i dobët në një sy. Kjo krijohet për shkak se syri nuk ka mundur të zhvillohet normalisht gjatë viteve të para të fëmijërisë.

PËRSE DUHET VIZITA TEK OKULISTI?

Testi i syve nuk është i njëjtë si një kontroll i syve nga një okulist. Rezultati jonormal do të thotë se fëmija rrezikon të zhvillojë një "sy dembel". Testi i Kind en Gezin (Fëmija dhe Familja) nuk ofron informacion rreth shkakut apo masës së anomalisë së mundshme të syrit.

Testet e mëtejshme nga një okulist janë të nevojshme për këtë gjë. Nganjëherë, një fëmijë referohet te një okulist, por specialisti nuk gjen asnjë anomali. Testi i syrit është vetëm një pamje e çastit, sytë e fëmijëve të vegjël zhvillohen vazhdimisht.

TEK OKULISTI

Këshillat e mëposhtme mund të jenë të dobishme për të siguruar që takimi me okulistin të shkojë mirë.

- Kur të caktoni takimin, përmendni se fëmija juaj është referuar pas një testi të syve të bërë nga Kind en Gezin.
- Nganjëherë mund të duhen rreth 2 muaj përpara se të mund të vizitoni okulistin. Nuk keni nevojë të shqetësoheni për këtë. Kontrolli nuk është urgjent, por është e rëndësishme që të bëhet.
- Caktoni një takim në momentin kur keni kohë të lirë të mjaftueshme vetë dhe nëse mundet, të mund të organizoni kujdes për fëmijët tuaj të tjerë. Nëse fëmija dhe pacienti(ët) është(janë) të relaksuar, kjo e bën kontrollin më të lehtë.
- Sillni me vete diçka për të ngrënë për fëmijën tuaj në rast se ai apo ajo kanë uri ndërkohë që ndodheni në dhomën e pritjes ose gjatë konsultimit.
- Okulisti do të bëjë një numër testesh, përfshi një test ku hidhen pika në sy. Do të prisni pak kohë pasi të hidhen pikat përpara se të bëhet testi.
- Pas kontrollit, okulisti do të vendosë nëse nevojitet trajtim apo jo. Nganjëherë, trajtimi shtyhet për fëmijët e vegjël, sytë e të cilëve janë ende në zhvillim e sipër. Vizitat dhe kontrollet e mëpasshme janë po ashtu të rëndësishme.